

ZRrEE-së, Prishtine, dhe
KEK-ut, Prishtinë,

Drejtuar edhe: Institucioneve dhe zyrtarëve të Republikës së Kosovës,
Mediumeve dhe gazetarëve,
Shoqërisë civile,
Palëve të interesuara.

Nga OJQ KONSUMATORI, Prishtine,
ok.kosova@gmail.com,
044/200-458

Lënda: KUNDERSHTIM I NGRITJES SE ÇMIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE.

KEK-u edhe sivjet aplikoi prane ZRrE-së me kërkesë për tarifa të reja të energjisë elektrike për vitin 2012, duke kërkuar që ngritja e çmimeve të bëhet sipas njëres nga tri variantet e ofruara, me arsyetim se me këto çmime do të mbulohet kosto e re prodhimit të energjisë elektrike e ndikuar nga kushtet e reja në prodhim e në treg.

Kërkesën e kundërshtojmë sepse fjala është edhe për një inercion, sepse kërkesa e KEK-ut nuk është e bazuar, pra nuk është arsyeshme; Vetë oferta e tre varianteve (që të trijat më të ulta se shkalla e humbjeve teknike e komerciale) dëshmon për pavendosëmërinë e KEK-ut dhe për paaftësinë që nga ulja e humbjeve teknike e komerciale t i sigurojë të tri shkallët nga variantet e ofruara. Jemi të mendimit se KEK-u as kësaj rradhe nuk ka shfrytëzuar gjithë rezervat e brëndshme, se ka mundësi dhe hapsira e fusha më të mëdha për ngritjen e performansave si dhe mund të bëj kursime edhe më të mëdha. Poashtu, KEK-u duhet t i përkushtohet përmbushjes së standardeve të cilësisë dhe të ketë kujdes ne problemet e mundshme sociale.

OJQ KONSUMATORI, Prishtinë, Kosovë mendon se KEK-u nuk ka arsye të reja as arsye më shumë për të bërë kërkesë për ngritjen e çmimeve të energjisë elektrike. Humbjet teknike dhe komerciale janë përgjegjësi e KEK-ut dhe për to nuk ka të drejtë t i gjobisë konsumatorët. Shkalla e inkasimit të konsumit të energjisë elektrike shënon rritje të pamjaftueshme, shkallë kjo që dëshmon për performansa akoma të ulëta të KEK-ut në këtë drejtim dhe tendencë permanente për të fajtuar konsumatorin të cilit tentohet ti faturohen edhe dobësitë e mangësitë menaxheriale, performansat dhe profesionaliteti i pamjaftueshëm ?! Konsumatori detyrohet t ia paguaj KEK-ut edhe importin e energjisë elektrike që “ imponohet nga mbingarkesa në pikun e ngarkesës nga konsumatorët dhe dalja nga sistemi “ ?! Edhe deri sivjet konsumatori taksapagues ia ka paguar KEK-ut këto shpenzime shtesë nga arka e Shtetit duke qenë taksapgues dhe gjenerues kryesor I Buxhetit të Kosovës. Por, KEK-u e injoron këtë fakt dhe akoma neglizhon kthimin e një pjese të kredisë së kthyeshme për këto destinime ?! KEK-u është neglizhent e shpërfillës edhe lidhur me përgjegjësitë që i ka për mosinkasimin e afro 450 MLN €, prej të cilave një pjesë e madhe është vjetërsuar / është parashkruar dhe gjasat janë tepër të vogla se ato para mund të këthehen ndonjëherë në arkën e KEK-ut ?!

Në rrethanat e reja, kur Qeveria rrefuzon që nga Buxheti t ia kompensojë humbjet dhe shpenzimet që janë rezultat I performansave jo të kënaqëshme, KEK-u, duke mos ditur të gjej rrugëdalje (prap performansat menaxheriale e profesionale) të vetmin ekuacion për zgjedhjen e problemit të parase e sheh xhepin e konsumatorit ?!

KEK-u harron se:

- Mbingarkesën e krijojnë ata që i ka toleruar e i toleron vetë për mospagesë, për kycje ilegale si dhe ata që ledhatohen si kanakarë të qarqeve të larta institucionale e partiake. Ndaj është detyrë e tyre të merret me ta e jo të gjobisin konsumuesin pagues të rregullt ?!
- Rrjedhjet teknike nuk janë pasojë e raporteve me konsumatorin ?!
- Shfaqja e “ dukurisë “ se mospagesës, e inkasimit të ulët, e vjetërsimit të borxheve nuk është përgjegjësi e konsumatorit.
- Krijimi i borxheve nga konsumatorët e Anës Veriore të Kosovës është problem politik të cilin KEK-u duhet ta zgjedhë në nivel politik e me Qeverinë e Kosovës. Pra, është më se e qartë se konsumatori i pjesës tjetër të Kosovës, pagues i rregullt dhe i disiplinuar i energjisë së shpenzuar elektrike, nuk është përgjegjës për këto borxhe dhe nuk mund të ngarkohet as me përgjegjësi as me pagesa shtesë ?! Konsumatori edhe ashtu nga Buxheti i Kosovës i ndau, edhe sivjet, mbi 4 MLN € për administratën e UNMIK-ut dhe për strukturat në Anën Veriore. Të paguajmë edhe energjinë elektrike përderisa ajo pjesë nuk kontribuon për Buxhetin e Republikës së Kosovës është pak ca e tepërt ?!
- Konsumatori i Kosovës nuk mund të jetë përgjegjës as për obligimin që e ka KEK-u në drejtim të ngritjes së vlerës dhe të imazhit para privatizimit dhe para investimeve të reja. Kjo përgjegjësi është e menaxhmentit dhe e atyre që këtë detyrë klase e detyrë shtëpie ia kanë caktuar KEK-ut (ndoshta edhe ZRrEE-së) ?!
- Nuk është përgjegjësi e konsumatorit nëse KEK-u importon energji elektrike me çmime tepër të larta. Është edhe përgjegjësi e institucioneve të Shtetit të Kosovës të cilët deri më tani u shfaqën tepër galant me paratë tona – të konsumatorit taksapagues, duke krijuar tabllo të rreme se ato para KEK-ut ia ndau Qeveria (sicc ?!).
- Nuk është as ide as përgjegjësi e konsumatorit Plani “ ABC “ - është ide e Projekt dështak i ndokujt tjetër, por edhe mungesë e përkushtimit e të vullnetit të mirë që konsumatorin ta trajtojnë si partner e jo si element biznesi që duhet eksploatuar ?!

Në anën tjetër KEK-u “ harron “ që konsumatorit t i ofrojë gjënë më konkrete dhe që i takon me Ligjin mbi standardet, me Ligjin për mbrojtjen e konsumatorit... por edhe moralisht dhe profesionalisht, si:

- Cilësinë,
- Sasinë,
- Kontinuitetin e furnizimit,
- Garantimin e tyre dhe sigurimin se produkti i KEK-ut, energjia elektrike, nuk do ti dobësojë, amortizojë tej mase e as t i prishë ose t i shkatërrojë aparatet, paisjet, impiantet, makinat, stabilimentet... elektrike në shtëpi, në biznes, në zyrë...
- KEK-u nuk ka të drejtë të sijellet si monopolist në treg dhe nuk duhet të harrojë se pasuria të cilën e menaxhon është pasuri e jona e përbashkët e “ jo pasuri private e një grusht njerëzve “ ?!
- Së këndejmi, duke pasur parasysh se produkti i KEK-ut, energjia elektrike, nuk e përmbushë asnjë element nga standardet, duhet pranuar se çmimi i këtij produkti, pra në krahasim me cilësinë, është tepër i shtrenjtë. Në këtë kontekst, çmimi i energjisë elektrike nga KEK-u është më i shtrenjti në Rajon ?! Së këndejmi edhe kërkesa / aplikimi I KEK-ut për tarifa të reja pa e mbështetur me cilësinë, sasinë, kontinuitetin e furnizimit, garantimin e tyre dhe sigurimin si dhe me shprehjen e vullnetit që KEK-u mos të sjellet si monopolist në treg, nuk duhet të merret fare në shqyrtim ?!

KEK-u nuk guxon të harrojë se ka kontratë me konsumatorin për furnizim me energji elektrike. Kjo kontratë përmbanë obligimin e KEK-ut për të furnizuar konsumatorin me energji elektrike konform standardeve kundrejt një pagese / çmimi / tarife të caktuar që mund të rinegociohet në kushte e rrethana të arsyeshme. Atëherë kur KEK-u “ harron “ t i përmbushë obligimet nga kontrata, obligimet që dalin nga Ligji mbi standardet, nga Ligji për mbrojtjen e konsumatorit...por edhe nga Ligji që rregullon fushën, lëndën dhe materien ku vepron KEK-u si dhe nga obligimet morale e etike profesionale ndaj konsumatorit rrezikon të amnistojë konsumatorin nga mospagesa për shkak të mospërmbushjes paraprake të obligimeve vetanake ?!

Edhe Plani ABC i redukimeve është diskriminues për konsumatorët pagues të rregulltë të cilët goditen nga ky Plan. Si i tillë bën që KEK-u të humbë besimin te kjo pjesë e konsumatorëve sepse ata pretendojnë se barazohen me borxhlinjtë e energjisë elektrike. Edhe Plani “ A+ “ për bizneset është ofendues, bile-bile diskriminues, sepse është interes strategjik i Shtetit që bizneset që gjenerojnë punë, zhvillim, para, vende pune... të kenë energji elektrike konform standardeve. Pra, është obligim madhor i KEK-ut që bizneseve t ju sigurojë energji elektrike e jo t i kushtëzojë ato. Mos të harrojë KEK-u se disa biznese i favorizon...ua mundëson edhe çmimet e ulura ?!

“ Blllok tarifa “, vonesa në leximin e njehsorëve duke i futur konsumatorët pa faj e pa dëshirë në “ blllok tarifë “ është veprim jokorrekt i KEK-ut ndaj konsumatorit dhe veprim shtesë në manipulimin e tarifës. Ndaj, edhe kësaj rradhe kërkojmë që blllok tarifa “ si mundësi e manipulimit dhe e zhvatjes permanente të konsumatorit nga KEK-u të hiqet !!!

E patëm thënë edhe më pare se faturat janë të pakuptueshme edhe për konsumatorët më të informuar. Ndaj kërkojmë që faturat të jenë më të kuptueshme, më të qarta dhe më transparente, më bindëse në korrektësinë e tyre.

KEK-u dëshmohe shpërfillës dhe harron se:

Donacionet, investimet, kreditë pa këthim, subvencionet e ndihmat tjera që i akordohen KEK-ut në të vërtetë jipen për t i përmirësuar kushtet në KEK për konsumatorin dhe KEK-u këto mjete duhet t i kalkulojë kështu e jo si mjete të adresuara për KEK-un.

Në rrethanat e rënies permanente të standardit të konsumatorit, të papunësisë, të varfërisë së afro 54% të konsumatorve prej të cilëve 18% skajshmërisht të varfër, kur pensionet e ndihmat sociale nuk kalonjë 80 €...KEK-u duhet të jetë i kujdesëshëm dhe të pyes vehten se a është dhe sa është i gatshëm të marrë përsipër barren e përgjegjësisë për pakënaqësitë që do të reflektoheshin me pamundësi / me rrezitim të pagesës që faturës ose me trazira sociale eventuale ?!

As ngritja e çmimit në prag të aplikimit të tarifave verore, më të ulta, kur nuk do të hetohej shtrenjtimi, nuk do të kalojë pa efekt negativ, pa efekt zingjiror dhe pa shprehje publike të pakënaqësive ?!

Mos të harrojmë se ngritjet e çmimeve të energjentëve, në veçanti të energjisë elektrike gjithëmonë kanë inicuar dhe do të shkaktojnë ngritjen zingjirore të çmimeve të të gjitha produkteve, mallrave e shërbimeve, uljen e standardit, uljen e konkurrueshmërisë së biznesit dhe këthimin mbrapsht të proceseve të zhvillimit ekonomik.

Kërkesa për çmime të reja nga KEK-u në MUAJIN BOTËROR TË KONSUMATORIT nuk mund të merret si gjest i mire ose i kulturuar, as gjest afarist i KEK-ut. Përkundrazi, kjo dëshmon grykësi dhe afinitet zhvatjeje të konsumatorit pagues të rregulltë i cili ndjehet përherë i diskriminuar përderisa KEK-u “ ledhaton “ ata që nuk paguajnë dhe e ngarkojnë “ pikun “, bëjnë ngarkesa dhe implikojnë importe.

Po e themi edhe me këtë rast, sepse çështja është plotësisht e njëjtë, se ZRrEE me siguri e ka parasyshtë se edhe interferimi i problemeve, si çështje e standardit të ulët të popullatës, është një nga faktorët determinues. Mungesa e kapaciteteve të mjaftueshme të ngrohjeve qendrore, mosfunksionimi i disave dhe mungesa e lëndëve djegëse si dhe ngarkesa e tepërtë me tatime e akciza të naftës si lëndë zëvendësuese për ngrohje ne njëjërë anë, e në anën tjetër vonesa e realizimit të mega projektit të ngrohjes qendrore për Prishtinën nga Obiliqi dhe e Mitrovicës nga TREPÇA ngarkon së tepërmi KEK-un, konsumatorin dhe arkën shtetërore. Ndaj, edhe barrën duhet ta bartim mbi supet tona – proporcionalisht.

Vlerësimet tuaja (të ZRrEE) lidhur me aplikimin e KEK –ut janë përgjegjësi e madhe por jo e papërbalueshme për ju. Ndaj, edhe kësaj rradhe:

1. Shpresojmë se do të bëni vlerësim korrekt dhe do të merrni vendim të drejtë e të denjë. Shpresojmë, besojmë dhe insistojmë që mos të ketë ngritje të çmimeve të energjisë elektrike në bazë të kërkesës së KEK-ut.

2. Kërkojmë sërish të hiqet blllok tarifa si e panevojshme dhe e pa-arsyetuar deri më tani.

3. Kërkojmë të ndërpriten çkyqjet e redukimet kolektive si dhe anulimin e Planit “ ABC “.

4. Kërkojmë anulimin e Planit “ A + “.

5. Kërkojmë më shumë përkushtim në inkasimin e faturave.
6. Kërkojmë standarde në prodhimin dhe plasmanin e energjisë elektrike, si q janë: sasia, kontinuiteti, çmimi, cilësia, dhe garantimi i tyre duke ia njohur të drejtën konsumatorit në reklamacion dhe kompensim të dëmeve.
7. Kërkojmë riformulimin e kontratës dhe marrjen parasyshtë të kërkesave tona në te.
8. Kërkojmë trajtim të denjë e jo qasje denigruese, nënçmuese...
9. Ofrohemi që, së bashku me ZRrEE-në, të bëjmë arbitrazhe të nevojshme që disa kërkesa të konsumatorëve mos të kalojnë ne Gjyq.
10. Ofrohemi që, duke zbatuar maksimën tone OFROHEMI QË NË PARTNERITET T I IDENTIFIKOJMË E ZGJEDHIM PROBLEMET, së bashku të kërkojmë, gjejmë e zbatojmë zgjedhje më të mira për të gjitha palët. Këtë ofertë e kemi dhënë edhe më pare dhe shpresojmë se, në vend të ankesave e arsyetimeve defetiste dhe akuzuese nga KEK-u, kësaj rradhe do të pranohet.

Shpresojmë se KUNDËRSHTIMI i OJQ KONSUMATORI do të mirepritet dhe se kërkesat tona do të gjejnë zbatim.

Përshëndetje e suksese.

21..03.2012

OJQ KONSUMATORI, Prishtinë, Kosovë,
Selatin Kaçaniku, kryetar,
ok.kosova@gmail.com,
044/200-458